



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Drejtoria e Logjistikës dhe Dixhitalizimit

Data	
Nr. Prot	

RELACION

PËR

PROJEKTVENDIMIN

“PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT PILOT PËR PROCESIN E VOTIMIT DHE NUMËRIMIT ELEKTRONIK TË VOTAVE, NË ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023 NË BASHKITË, ELBASAN, KAMËZ DHE VORË”

Referuar nenit 19, pikat 1, shkronja "n" dhe 2 të Kodit Zgjedhor, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe vendimit nr. 4, datë 13.11.2020, të Komisionit Rregullator, "Për llojin dhe karakteristikat teknike që duhet të plotësojnë sistemet dhe pajisjet e votimit dhe numërimit elektronik që prokurohen dhe përdoren në zgjedhje në Republikën e Shqipërisë", kërkohet përcaktimi i zonës/ve zgjedhore ku do të zbatohet projekti pilot i votimit dhe numërimit elektronik.

Projekti pilot i votimit dhe numërimit elektronik u zbatua për herë të parë në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021, në ZAZ nr. 40, Qarku Tiranë, si dhe në zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie, të datës 6 Mars 2022, në bashkinë Vorë.

Pas pilotimit të suksesshëm në dy rastet e sipërpërmendura, propozohet që projekti pilot për procesin e votimit dhe numërimit elektronik të zbatohet edhe për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të 14 maj 2023.

KQZ kishte konsideruar shtrirjen e këtij projekti, veçmas bashkisë Vorë, edhe në 6 bashki të tjera. Për këtë qëllim KQZ i kërkoi Këshillit të Ministrave dhe Kuvendit një fond në vlerën e [...] Lekë.

Nëpërmjet Ministrisë së Financave, KQZ ka marrë njoftimin, se Këshilli i Ministrave ka miratuar një fond në vlerën e 800,000,000 Lekë për zgjerimin e votimit elektronik në zgjedhjet e datës 14 maj 2023.

Në përputhje me fondin e vënë në dispozicion konkludojmë se ai është i mjaftueshëm për zhvillimin e votimit elektronik në 352 qendra votimi, veçmas bashkisë Vorë. Duke marrë në konsideratë këtë numër qendrash votimi, kohën në dispozicion të realizimit të këtij projekti, si dhe dobinë për zhvillimin e tij në ambiente gjeografike të ndryshëm rekomandohet zhvillimi i votimit elektronik edhe në bashkitë Elbasan dhe Kamëz, përkatësisht ZAZ 47, 48, 49, 50 dhe për bashkinë Kamëz në ZAZ 27 dhe 28; për bashkinë Vorë, përkatësisht ZAZ 26.



Në zbatim të nenit 22 të Kodit Zgjedhor, ku përcaktohen kompetencat e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve lidhur me teknologjinë në zgjedhje, do të zbatohet e njëjta procedurë për fazën pasuese të implementimit të këtij projekti në Bashkitë Elbasan, Kamëz dhe Vorë në zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore të datës 14.05.2023.

Për sa më sipër në këtë relacion, Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, brenda kompetencave të veta dhe në respektim të detyrimeve e afateve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, i paraqitet për shqyrtim dhe miratim projektvendimi “Për zbatimin e projektit pilot për procesin e votimit dhe numërimit elektronik të votave, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023 në bashkitë Elbasan, Kamëz dhe Vorë”.

Daniela ALIMEMETI	Drejtorja e Logjistikës dhe Dixhitalizimit
Madalena KOJA	Drejtorja e Ligjshmërisë
Majlinda ÇELMETA	Drejtorja e Përgjithshme e Administrimit të Zgjedhjeve
Aurel LAMÇE	Drejtorja e Përgjithshme Rregullatore, Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse
Ylli MERKAJ	Sekretar i Përgjithshëm





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data:01.2023

Nr:

Ora::.....

PROJEKTVENDIM

PËR

**ZBATIMIN E PROJEKTIT PILOT PËR PROCESIN E VOTIMIT DHE NUMËRIMIT ELEKTRONIK TË
VOTAVE, NË ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE, TË DATËS 14 MAJ 2023, NË
BASHKITË ELBASAN, KAMËZ DHE VORË**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja "n" dhe 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, të vendimit nr. 4, datë 13.11.2020, të Komisionit Rregullator, "Për llojin dhe karakteristikat teknike që duhet të plotësojnë sistemet dhe pajisjet e votimit dhe numërimit elektronik që prokurohen dhe përdoren në zgjedhje në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve,

VENDOSI:

1. Zbatimin e projektit pilot për procesin e votimit dhe numërimit elektronik të votave, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 maj 2023, në bashkitë Elbasan, Kamëz dhe Vorë.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqe elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: ... 2023 Nr:
Ora:



"Për zbatimin e projektit pilot për procesin e votimit dhe numërimit elektronik të votave, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 Maj 2023, në bashkitë Elbasan, Kamëz dhe Vorë"